



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR ARSIMIN,
SPORTIN DHE RININË
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT TË KUADRIT RREGULLATOR

Nr. 823 Prot.

Tiranë, më 25.01. 2019

Lënda: Dërgohet për mendim një projektvendim

UNIVERSITETIT TË TIRANËS
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS
UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË
UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS
UNIVERSITETIT TË ARTEVE, TIRANË
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
UNIVERSITETIT TË SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”
UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN
UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI”, VLORË
UNIVERSITETIT “FAN S. NOLI”, KORÇË
UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ”, GJIROKASTËR
UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS
AKADEMISË SË STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE, TIRANË
AKADEMISË SË FORCAVE TË ARMATOSURA
AKADEMISË SË SIGURISË

Të nderuar rektorë,

Bashkëlidhur po Ju dërgojmë për mendim projektvendimin e Këshillit të Ministrave, “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësinë e tyre”.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

Konceptoi:	A. Gjini
Miratoi:	E. Tola
Konfirmoi:	O. Muzaka

MINISTËR

BESA SHAHINI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. __, datë _____

PËR

**OFRIMIN NGA INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË
TË SHËRBIMEVE NË PËRPUTHJE ME VEPRIMTARINË E TYRE,
PËR INSTITUCIONET E QEVERISJES QENDRORE DHE
INSTITUCIONET NË VARËSINË E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, neneve 18, 19 dhe 95 të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore apo institucionet në varësinë e tyre, të kërkojnë fillimisht sipas nevojave, shërbime me fonde buxhetore, si konsulenca, studime apo ekspertiza nga institucionet publikë të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit.
2. Për shërbimet e ofruara sipas këtij vendimi, institucionet publike të arsimit të lartë, zbatojnë tarifat e miratuara sipas legjislacionit në fuqi dhe në mungesë të tyre miratojnë tarifa me akte të brendshme. Tarifat e miratuara me akte të brendshme, duhet të jenë jo më shumë se mesatarja e vlerave të tregut për shërbimin përkatës të kërkuar.
3. Bordet e Administrimit në institucionet publikë të arsimit të lartë, miratojnë tarifat për shërbimet e ofruara për institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, si dhe për të tretët.
4. Institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, nënshkruajnë kontratë shërbimi me titullarin për çështjet financiare dhe administrative të institucionit publik të arsimit të lartë.

5. Përgjegjësi i njësisë përkatëse kryesore që ofron shërbimin, nënshkruan marrëveshje me titullarin për çështjet financiare dhe administrative të institucionit publik të arsimit të lartë, për mënyrën e administrimit të të ardhurave dhe masën e shpërblimit të stafit akademik dhe ose studentëve të angazhuar në ofrimin e shërbimit, marrëveshje e cila miratohet nga Bordi i Administrimit.
6. Institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, vijojnë me procedurat e prokurimit publik sipas legjislacionit në fuqi, në rastet kur:
 - a) cilësia e shërbimeve të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë nuk është sipas marrëveshjes së nënshkruar;
 - b) shërbimet e kërkuara nuk realizohen nga institucionet publike të arsimit të lartë apo tarifat e ofruara nga këto institucione nuk janë sipas përcaktimeve të këtij vendimi.
7. Ngarkohen Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore, institucionet në varësinë e tyre dhe institucionet publike të arsimit të lartë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

E D I R A M A